

Albanian

Bërje ankese tek
Avokati i Popullit



COMMONWEALTH
OMBUDSMAN

Avokati i Popullit i Commonwealth-it heton ankesat në lidhje me veprimet administrative të subjekteve të Qeverisë Australiane dhe organizatave të përshkuara të sektorit privat.

Si mund t'ju ndihmojë Avokati i Popullit

Nëse ju mendoni se jeni trajtuar padrejtësisht, ju mund të ankoheni në zyrën e Avokatit të Popullit.

Lloji i ankesave që ne hetojmë përfshin:

- > **Agjencitë** – përgjegjëse për shërbime të tilla si të mirëqenies dhe pagesave për mbështetjen e fëmijëve, shërbimet shëndetësore federale dhe të transportit.
- > **Shërbimet** – e kryera nga shumica e kontraktorëve privatë për Qeverinë Australiane.
- > **Liria e informacionit (FOI)** – duke përfshirë vonesat në shqyrtimin e kërkesave në lidhje me FOI.
- > **Policia Federale Australiane (AFP)** – veprimet e anëtarëve të AFP dhe rreth rregullave, praktikave dhe procedurave të AFP si agjenci.
- > **Industria postare** – Posta Australiane dhe operatorët postarë privat të regjistruar me skemën Avokati i Popullit për Industrinë Postare (PIO).
- > **Siguracioni shëndetësor privat** – Anëtarët e fondit shëndetësor, fondet shëndetësore, spitalet private apo praktikuesit mjekësorë. Ankesat duhet të jenë në lidhje me një marrëveshje të sigurimit shëndetësor.
- > **Studentët e huaj** – problemet që studentët e huaj të ardhshëm, aktual apo të mëparshëm kanë me shkollat private, kolegjet dhe universitetet në Australi.
- > **Australian Capital Territory (ACT)** – veprimet administrative të Qeverisë së ACT.

Si të bëni një ankesë

Për të zgjidhur problemin përpiquni në rradhë të parë të kontaktoni departamentin që merret me shqyrtimin e ankesave të agjencisë përkatëse. Nëse ju nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e agjencisë, na kontaktoni ne.

Çfarë ndodh kur ju bëni një ankesë me ne?

Ne do të shqyrtojmë ankesën tuaj me kujdes dhe sa më shpejt të jetë e mundur. Ne mund t'ju kërkojmë më shumë informacion, si p.sh. letrat apo dokumenta të tjera, ose do t'ju kërkojmë që të bëni ankesën tuaj me shkrim.





Na Kontaktoni

Me telefon

Telefononi **1300 362 072** midis 9 am dhe 5 pm (AEDT) nga e Hëna në të Premte.

Online

Vizitoni **www.ombudsman.gov.au**

Me shkrim

GPO Box 442, Canberra ACT 2601

Shërbimet në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar të bëni një ankesë

Nëse ju jeni një person që nuk flet Anglisht, ne mund t'ju ndihmojmë përmes Shërbimit të Përkthimit (TIS) në **131 450**. Nëse keni vështirësi në dëgjim, shikim ose në të folur, një Shërbim TTY është në disponim nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Transmetimit në **133 677**.

**SHËRBIMET E AVOKATIT TË
POPULLIT JANË FALAS**